



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201602051/8

Tiranë ___/___/2016

Lënda: Rekomandohet "Marrja e masave me qëllim zbatimin korrekt të dispozitave procedurale për "Arrestin në flagrancë" dhe "Kontrollin të banesës" ndaj autorëve të dyshuar për kryerjen veprës penale, sidomos kur ato janë persone femra".

Analizën e rastit të "arrestit në flagrancë" të shtetasës B. M., dhe, marrjen e masave disiplinore ndaj z. D. L., dhe I. H., punonjës në Komisarriatin e Policisë Maliq, të cilët kanë kryer shkeljet.

Drejtuar : Shefit të Komisarriatit të Policisë
Z. Alban HOXHA

MALIQ

Për dijëni: Drejtuesit të Drejtorisë të Policisë të Qarkut
Z.Ajet ZYBERI

KORÇË

Të nderuar Zotërinj,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit më datë 12.10.2016, ka paraqitur ankesë shtetasi N. M., nga Drithasi i Korçës, i cili ka ngritur shqetësimin se Policia Gjyqësore e Komisarriatit të Policisë Korçë, ka kryer veprime të paligjshme dhe konkretisht, më datë 13 Shtator 2016, ka ushtruar kontroll banese pa vendim dhe më pas arrestimin e padrejtë të bashkëshortes së tij znj. B. M., 61 vjeç, persone e dyshuar për mbajtje të armëve shpërthyes, granata, të cilat, pas kryerjes së ekspertimit teknik rezultuan se ishin mësimore.

Sipas ankuesit N. M., punonjësit e policisë kanë cënuar dhe dinjitetin e bashkëshortes dhe familjes së tij, kjo për faktin se duke e ditur që ajo ishte e moshuar e kanë çuar për ekzaminim tek mjeku gjinekolog.

Rrethanat e ngjarjes

Në ditën e ngjarjes datë 13.09.2016, rreth orës 17.00, pas sinjalizimit të shtetasit E. Xh., nga Drithasi, për konflikt me komshiun N. M., në vënd kanë shkuar punonjësit e Komisarariatit të Policisë Maliq, të cilët kanë kryer dhe veprimet hetimore proceduriale. Punonjësit e policisë I. H., dhe D. L., kanë gjetur dy struktura të dy granatave, pa detonatorë, të cilat ndodheshin mbi murin rrethues të oborrit të banesës së shtetasit N. M.

Në deklaratimet e saj, shtetësja B. M., ka shpejguar se në oborrin e saj ishin hedhur gurë, nga komshijtë e familjës së shtetasit E. Xh., me të cilët kanë patur konflikte pronësie. Gjatë pastrimit të oborrit të shtëpisë, ajo ka gjetur dy granata të cilat i ka vendosur tek muri ndarës mes dy banesavë në afërsi të portës .

Në deklaratimet e tij shtetasi N. M., që është dhe bashkëshorti i të arresturës B. M., ish ushtarak me njohuri për armët dhe lëndët shpërthyesë luftarake, i ka sqaruar punonjësit e Komisarariatit të Policisë Maliq dhe për faktin se dy armet shpërthyesë, struktura granatash ishin mësimore, çka dukej me sy të lirë dhe prej tyre. Megjithatë, punonjësit policisë në mënyrë të nxituar dhe pa njoftuar prokurorin e gatshëm kanë kryer “arrestin në flagrancë” të shtetas B. M., si persone e dyshuar për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa lejë e armëve shpërthyesë në banesë”, parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal, i ndryshuar.

Veprimet e kryera

Me qëllim verifikimin e shqetësimit dhe rpretendimeve të shtetasit N. M., është ndërmarrë kryerja e një hetimi të pavarur administrativ, i cili ka konsistuar në marrjen e deklaratimeve të ankuesit, punonjësve të policisë I. H., K. T., dhe D. L., punonjës policie të Komisarariatit të Policisë Maliq.

Veç sa sipër është kërkuar informacion Komisarariatit të Policisë Maliq dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, të cilët i janë përgjigjur shkresave tona, bashkëlidhur dhe dokumente të ndryshme shkresore, duke përfshirë dhe vendimin e pushimit të procedimit penal nr.1021, marrë nga organi i Prokurorisë më datë 29.09.2016.

Konstatime dhe sugjerime

Duke paraqitur ankesën në Institucionin e Avokatit të Popullit, qytetari N. M., ka ngritur me shqetësim sjelljen jo korrekte dhe profesionale të punonjësve të Komisarariatit të Policisë Maliq, duke filluar nga kryerja e kontrollit të banesës pa vendim, hetimi jo i plotë i rrethanave të çështjes, nxitimin në arrestimin në flagrancë të bashkëshortes së tij B. M., dhe, çuarjen e saj për ekzaminim tek mjeku gjinekolog edhe pse është persone e moshuar.

Duke analizuar në tërësi veprimet e punonjësve të Komisarariatit të Policisë Maliq konstatohet se:

Së pari: Kryerja e kontrollit të banesës të shtetasit N. M., është realizuar në kundërshtim me dispozitat e neneve 202 dhe 203 të Kodit të Procedurës Penale.

Kryerja e kontrollit të banesës së shtetasit N. M., me iniciativë nga Policia Gjyqësore e K.P.Maliq, nuk është e përligjur si për faktin se armët “shpërthyesë” nuk ishin të fshehura, por të vendosura në një vënd të dukshëm të treguara nga e kontrolluara, dhe të shikuara në mënyrë të dukshme nga punonjësit e policisë.

Asnjë përpjekje nga punonjësit e policisë për t’i bërë thirrje personit të kontrolluar për dorëzimin e armëve “shpërthyesë”, e kundërta do të ishte një sjellje profesionale e tyre, dhe zbatim i drejtë i Pikës 1 të nenit 203 të Kodit të Procedurës Penale.

Nga studimi i përmbajtjes së proces verbalit të kontrollit të vëndeve datë 13.09.2016, mbajtur nga Oficeri i Policisë Gjyqësore z.I. H., konstatohet se nuk ka pasqyrim real të veprimit të kryer dhe të pretendimeve të personave të kontrolluar, pa pjesëmarrjen e personave të pranishëm në kryerjen e këtij veprimi hetimor procedural.

Po ashtu, shkuarja e punonjësve të policisë në vëndin e ngjarjes, me grup hetimor le për të dëshiruar, pasi në përbërje të këtij grupi nuk kishte ekspert të fushës xhenjere, i cili duke patur njohuritë e nevojshme, qysh në fillim do të konstatonte se dy armët “shpërthyesë” nuk ishin luftarake, por mësimore siç rezultoi dhe nga konkluzioni i ekspertimit teknik të tyre.

Policia Gjyqësore duhet të njohë dhe respektojë të drejtën që ka personi i dyshuar për kryerjen e një veprë penale, çka konsiston në verifikimin e kërkesave apo pretendimeve të tij qysh në fazën e kryerjes së veprimeve të para hetimore procedurale. Kjo është një procedurë që duhet të udhëhiqet nga parimi i prezumimit të pafajësisë si dhe duhet të menaxhohet me profesionalizëm të lartë, korrektësi dhe paanësi

Së dyti: “Arrestit në flagrancë” i shtetasës B. M., është i nxituar nga Policia Gjyqësore, kjo jo vetëm për faktin që e arrestuara është personë femër, por dhe moshë e saj e madhe, 61 vjeç. Jemi në dijeni të faktit që Këshilli i Ministrave miratoi projektligjin “Për Dhënie Amnistie”, propozuar nga Ministri i Drejtësisë, ku me të drejtë në kriteret për përfitimin e Amnistisë pëfshihen edhe personet femra mbi moshën 60 vjeç.

Për rastin e aplikimit të “Arrestit në flagrancë” të qytetares B., nuk ekziston asnjë prej kriterëve të parashikuara në nenin 228/3 të Kodit të Procedurës Penale, siç janë mospasja e asnjë shkak të rëndësishëm për vënien në rrezik për marrjen ose vërtetësinë e provës, dhe pa asnjë rrezik për largimin e personit të dyshuar.

Vepra penale për të cilën dyshohet qytetarja B. M., nuk paraqet rrezikshmëri të madhe shoqërore dhe po kështu vetë e dyshuara, e cila paraqitet me personalitet të mirë.

Vendosja e masës së sigurimit personal “Arrest në flagrancë” duhet të jetë një rast përjashtimor dhe si masë e fundit, e cila duhet të aplikohet në përshtatje me shkallën e nevojave të sigurimit, të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikon vepra penale, si dhe kur masat e tjera nuk janë të përshtatshme për shkak të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe të autorit të saj.

Standarti kryesor për privimin e lirisë së personit nëpërmjet arrestimit është arsyeshmëria, e parë kjo në kontekst me rrethanat konkrete dhe arsyet e veçanta të faktit i cili duhet të derivojë në sjellje apo marrjen e vendimeve në favor të subjekteve më të dobëta.

Në respektim të dispozitave procedurale të sipërpërmendura, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me të drejtë, ndaj shtetasës B. M., vendosi masë sigurimi “Detyrim për Paraqitje në Polcinë Gjyqësore”.

Së treti: Nga përmbajtja e nenit 111 të ligjit nr.108/2014, “Pë Policinë e Shtetit”, nuk rezulton që shtetaset femra pas arrestimit në flagrancë dhe vendosjes në dhomat e sigurisë duhet të ekzaminohen tek mjeku gjinekolog. Ndërsa në nenin 114 të ligjit të mësipërm, ndërmjet të tjerave, thuhet se kontrolli mjekësor i personit bëhet vetëm me vendim gjykatë.

Veç sa sipër do të sugjeronim manifestimin e një sjellje etike policore dhe respektimin e standarteve profesionale, pasi vetëm në këtë mënyrë dhënia e shërbimeve të policisë me komunitetin është e cilësisë më të lartë. Kjo për faktin se dhe në nenet 2 dhe 85 të ligjit nr.9749 datë 04.06.2007, “Për Policinë e Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr.108/2014, të cilat bëjnë fjalë për misionin dhe parimet e veprimtarisë së Policisë së Shtetit, ruajtja e rendit dhe sigurisë publike nëpërmjet zbatimit të ligjit duhet të realizohen në respekt të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Rasti i mësipërm duhet të bëhet objekt i një analize, dhe të punohet me efektivat e policisë së Drejtorisë, me qëllim që nga Policia Gjyqësore” e Policisë së Shtetit të respektohen dispozitat procedurale, si për “kryerjen e kontrollove të vëndeve”, “arrestin në flagrancë”, ashtu dhe të dispozitave ligjore që bëjnë fjalë për “ndalim/arrestimin e personave sipas kërkesave të nenit 85 dhe 111 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Për të gjitha arsyet dhe shkaqet e përmendura më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në nenin 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

REKOMANDOHET

“Marrja e masave me qëllim zbatimin e dispozitav e procedurale për rastet e “Arrestit në flagrancë” dhe “Kontrollit të banesës”, ndaj autorëve të dyshuar për kryerjen e veprës penale sidomos kur bëhet fjalë për persone femra.

Analizën e rastit të “arrestit në flagrancë” të shtetasës B. M., dhe marrjen e masave disiplinore ndaj z.D. H., dhe I. L., punonjës në Komisariatin e Policisë Maliq, të cilët kanë kryer shkeljet..

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi , të vihemi në dijeni brënda afatit 30 ditor , sipas nenit 22 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” , me ndryshimet përkatëse.

Bashkëlidhur ju dërgojmë dokumentet e mëposhtëme:

1. Ankesa e shtetasit N. M., datë 10.10.2016, 2-dy- fletë.

2. Proces verbal i marrjes së deklarimeve të shtetasit N. M., datë 20.10.2016, 3-tre- fletë.
3. Proces verbali i marrjës së deklariemeve të punonjësve të polciisë I. H., D. L., dhe K. T., datë 21 Tetor 2016, 3-tre- fletë.
4. Proces verbal i kontrollit të vëndeve datë 13.09.2016, 2-dy-fletë.
5. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë datë 15.09.2016, për caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasës B. M.
6. Vendimi i pushimit të procedimit penal nr.1021/2016, marrë më datë 29.09.2016, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqsëor Korçë, 3-tre- fletë.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj.

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI